

Buxheti me pjesëmarrje

Zoti Peleshi, fjalën e kam unë, apo e ke ti

Portrete

Zogjtë e Nositit

Nga Kopi Kyçyku

Sapo ka shkrepur rrezja më e parë e diellit, që përshfaqet mes reve, si zog në fluturim. Ajri i lagur nga avullimi i ujit të liqenit të çan hundët me erën e livandos, që vjen nga fije bari të thatë, të stërkitura nga freskia e vesës. Nga larg më vijnë tinguj të zbehur thëllëzash a gargujsh. Mollët vjeshtore qeshin si fëmijë me fytyra të zbardhura nga shkumë sapuni

Lexoni në faqen 4

Intervista

Cilësia, kërkesa numër 1

-intervistë me z.Illir Duka administrator i Entit Botues "D.I.J.A Poradeci"

Të botosh një gazetë apo "hapësira lirie në letër"!

-intervistë me kryeredaktoren e gazetës "Nositi", zonjën Afroviti Gusho

Lexoni në faqen 6

15 vjet NOSITI

"Nositi":

Scriptum manent

Duke lexuar edicionet e para të gazetës "Nositi", të vitit 1994, lehtësisht mund të bësh dy "zbulime": Së pari, në faqet e gazetës duket sikur koha është ndalur duke fiksuar ngjarje, personazhe, pamje, prononcime, ide... Eshtë një lloj fotografie, por në përmasa shumë më të gjera e të detajuara

Lexoni në faqen 2

Reportazh

Botime në vite të Sh.B.

"D.I.J.A - Poradeci"



Lexoni në faqet 7-8-9-10

Letërsi

POEZI TE KONKURSIT NOSITI



Lexoni në faqet 11-12-13-14



BANKA POPULLORE

SOCIETE GENERALE GROUP

"Nositi": Scriptum manent

Duke lexuar edicionet e para të gazetës "Nositi", të vitit 1994, lehtësisht mund të bësh dy "zbulime":

Së pari, në faqet e gazetës duket sikur koha është ndalur duke fiksuar ngjarje, personazhe, pamje, prononcime, ide... Është një lloj fotografie, por në përmasa shumë më të gjera e të detajuara. Zakonisht kujtesa e njerëzve për ngjarje publike është e shkurtër. Ne tani e kemi të vështirë të risjellim në kujtesë se ç' mendonim për njerëzit, për situata të caktuara, për ndryshimet e ndodhura, për risitë, për personat publikë.

Ata që kanë shkruar në gazetë, mund ta shohin veten në këtë pasqyrë si kanë qenë 15 vjet më parë dhe ndoshta do të befasonen. Por edhe një lexues i thjeshtë mund të habitet duke kërkuar midis rreshtave të faqeve të zverdhura nga koha. Në këtë kuptim gazeta merr vlera të pazëvendësueshme, duke u bërë dëshmitare autentike e kohës dhe e ngjarjeve. Jo më kot historianët dhe studiuesit, u referohen në punën e tyre gazetave të kohës. Pra gazetën "Nositi", nuk mund ta zëvendësojë dot asnjë arkiv apo dosje, për atë pasqyrim besnik e të detajuar që i ka bërë jetës së Pogradecit dhe qarkut të Korçës në këta 15 vjet.

Së dyti, ndërsa lexon edicionet e para të gazetës, "zbulon" se në disa fusha koha vetë ka ndalur në vend. Në një intervistë që kryetari i bashkisë Zhani Treska i ka dhënë kryeredaktores në nr.1 të "Nositit", bëhet fjalë për Pogradecin turistik, për kolektorin, ujin e pijshëm, energjinë elektrike, pastërtinë e mjedisit... Në një edicion tjetër flitet për të përndjekurit, për kompensimin e ish pronarëve... A thua se këto shkrime janë të ditëve tona e jo të vitit 1994.

Këtë s'e mbanim mend, na e kujtoi koleksioni i "Nositit" të mbijetuar. Prandaj mbetet gjithmonë aktuale thënia e lashtë latine "Verba volant, scriptum manent" që në shqip mund të shprehet "Fjalët i merr era, e shkruara mbetet".

I.Buzali**I dashur lexues!**

Sot duke soditur rreshtin e pafund të gazetave, ndale tek "Nositi". Të tërhoqi emri:

"Nositi", ky zog i përjetësuar në poezinë e Lasgushit, nuk ekziston më në Pogradec. U rikthye nëpërmjet kësaj gazete dhe erdhi tek ti. Pastaj ti lexove se kjo është gazetë e Pogradecit dhe e more me vehte. Pa e shfletuar ende, pyete veten se çfarë do doje të lexoje në gazetën e qytetit tënd. Gjithshka ke më të dashur në këtë qytet, gjithshka që të kujton fëmijërinë, ngjyrat që të kanë rrethuar, bardhësi në dimër e kaltërsi në verë. Diçka e largët që të josh, emra të harruar që duhen risjellë në të sotmen.

E kaluara, por dhe e ardhmja. Pesimizmi, por sidomos shpresa. Do kërkojë diçka nga vetvetja në faqet e "Nositit". Diçka që do të të çonte sa më afër të vërtetës, të ndjeje aty gëzimin, hidhërimin, dyshimin, pasigurinë, jetën e pasur, varfërinë, suksesin por edhe dështimin, ëndrrën apo realitetin. Duke lexuar të vërtetën do ndihesh më i lirë...

Ti sot more në dorë "Nositin", dhe, duke e ditur që ky është zog i vetëflijimit mendove se të gjithë duhet të sakrifikojmë sadopak prej vehtes për hir të mbijetesës.

Dhe përsëri urove mirseardhjen e "NOSITIT".

"Nositi", 15 qershor 1994

Dy urime nga Korça

Gazeta "Nositi" ka shumë dashamirës në Korçë. Po ne mundëm të shkëpusim mendimet e dy prej miqve më të vjetër të saj, Aleko Ballaurit dhe Ali Bregut, të cilët nuk i janë ndarë edhe me të lexuar, por edhe herë pas here me botime në faqet e saj. Në këto vite të ndryshimeve janë shfaqur një sërë titujsh gazetash, por që nuk kanë mbijetuar. Ato kanë mbetur si copëra relikesh jo të një kohe të shkuar, po për një kohë të shkuar të tyre. Një prej gazetave lokale që erdhi gjithmonë në rritje dhe sot feston 15-vjetorin është dhe gazeta "Nositi", ku urimet dhe përgëzimet shprehen lirshëm si nga lexuesit edhe nga ne që bashkëpunojmë.

Aleko Ballauri

shprehet me rastin e këtij përvjetori:

"Në këto 15 vjet të daljes së saj gazeta "Nositi" është shfaqur si një gazetë prestigjoze, e lexueshme dhe e kuptueshme. Nga viti në vit ka ardhur duke e rritur brendinë e saj, pa iu larguar boshtit të fortë që ajo

ka duke na dhënë lajme të besueshme, duke shkruar për figura e për traditën. Një gazetë që e ka shmangur sensacionin ditor. Me këtë rast falënderoj stafin botues e drejtues të saj, duke shprehur dëshirën për të na dhënë edhe në të ardhmen një mbështetje me faqet e gazetës."

Ali Bregu uron:

"Për mua "Nositi" ka qenë në këto 15 vite një gazetë që më ka ushqyer shpirtin me materiale interesante, aktuale për Pogradecin dhe për Korçën. Ka trajtuar figurat pikante të trevës, ka pasqyruar traditën. Nuk e ka lënë mënjane edhe trajtimin e problemeve të kulturës. Është një gazetë me materiale të besueshme. Mbijetesa e saj qëndron tek stafi që e drejton dhe tek lexuesit dhe bashkëpunëtorët e tjerë që shkruajnë në këtë gazetë. Urime me gjithë shpirt e zemër dhe përvjetorë të tillë si ky i sivjetmi mos kenë kurrë fund për këtë gazetë."

P.Çuni

Për 15 vjet me radhë ne dhe ju, së bashku, i dhamë jetë gazetës "Nositi": ne si botues, ju si bashkëpunëtorë, lexues, kritikë, dashamirës dhe miq. Që prej vitit 1994, për 15 vjet, së bashku i dhamë "Nositit" fytyrën që ka sot. Një gazetë e komunitetit, e pranishme në gëzimet dhe problemet e çdo familjeje, çdo faqe -një bashkëbisedim i singertë me ju.

Ne dhe ju së bashku fiksojmë historinë në fletët e Nositit

Chris Braithwaite

Botues i të përjavshmes Chronicle në Barton, Vermont, SHBA.

Ndryshe nga zogu i zhdukur, emrin e të cilit mban, gazeta Nositi është një e mbijetuar. E përjavshmja e vogël u krijua në Pogradec më 1994, mbijetoi zezonën e 1997.

...Unë kam besuar dhe besoj se jeton si rezultat i aftësisë, vendosmërisë dhe përkushtimit të njerëzve të saj. Unë gjithashtu besoj se një gazetë me njerëz të tillë, të cilët e kanë të qartë rolin e tyre në komunitet dhe me një vizion të qartë për të ardhmen, ka një shans të shkëlqyer për t'u rritur e lulëzuar.

11 maj 2002

Buxheti me pjesëmarrje

Të marrësh pjesë në diskutime të hapura për projektbuxhetin e Bashkisë si qytetar në radhë të parë dhe si drejtues e krijues, është një mundësi bashkëbisedimi dhe shprehje mendimesh që kanë të bëjnë me fytyrën e nesërme të vetë qytetit ku banojmë dhe jetojmë. Unë si qytetar të respektova dhe erdha në takim. Me shpresën e mirë që këto takime të mos dalin formale edhe unë mora pjesë në takimin që u organizua mes lagjeve 1, 2, 3 të qytetit të Korçës, nën logon "Fjalën e ke ti". Edhe unë parashtrova disa sugjerime për artin dhe letërsinë që të mos trajtohen në mënyrë të njëanshme nga ana e Bashkisë. Ish dhe një mundësi e mirë për të qenë ballë për ballë me kryetarin e Bashkisë për vetë vështirësitë e krijua për ta takuar në Bashki.

Fjalë për artin

Në takim unë e mora fjalën me dëshirën e mirë që fjalët e mia t'i shërbejnë zhvillimit të artit dhe kulturës së qytetit tonë me tradita dhe jo për të shprehur ndonjë pakënaqësi apo mllef të krijuar si rezultat i qëndrimit refraktar të institucioneve përgjegjëse për artin dhe kulturën, të instaluar pranë pushtetit lokal, ndaj një sërë projektsh dhe propozimesh që unë kam bërë në të kaluarën, në emër të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Korçës.

Patjetër që është e lehtë dhe komode të mbash një qëndrim oportunisti dhe dallkauku në raport me pushtetin, por një qëndrim i tillë jo vetëm që nuk do të ishte dinjitoz, por edhe i dëmshëm dhe nuk do t'i shërbente aspak qëllimit, për të cilin ne mbledhemi në takimet për diskutimin e projektbuxhetit të vitit që vjen. Buxhetim me pjesëmarrje, por që të mos mbetet formal.

Të gjithë ne njerëzit e penës e dimë dhe e kemi të qartë se një qytet modern nuk ka nevojë vetëm për një infrastrukturë bashkëkohore urbane, por në radhë të parë për infrastrukturën e vet shpirtërore, elemente të rëndësishëm të së cilës janë edhe arti e kultura në përgjithësi. Për të ecur

përpara në këtë drejtim, na duhet që të kthejmë edhe kokën pas, në sensin pozitiv, që të gjykojmë se çfarë kemi bërë mirë dhe çfarë duhet të synojmë, për të përmirësuar punën tonë në të ardhmen.

Takimi i rezervuar nga kryetari i Bashkisë

Në fillim të mandatit, kryetari aktual i Bashkisë së Korçës, Niko Peleshi më rezervoi një takim, ku unë në cilësinë e kryetarit të LSHA-së së Qarkut Korçë i shpreha një sërë rezervash dhe obsionesh në drejtim të zhvillimit të artit dhe kulturës, të cilat jo vetëm që nuk u morën parasysh, por për çudi u ngulmua edhe më shumë në dëshirën e tij për të mos bashkëpunuar, gjë e pakuptueshme për ne....!? Ishte fillimi i mandatit të kryetarit dhe për shumë arsye, nga përvoja e të mëparshmeve patëm besim se ky i riu do të ndryshonte kursin e marrëdhënieve me qytetarët dhe njerëzit e artit.

Ku konsistonin qëndrimet tona

Kishim vënë re se i vetmi aktivitet i përvitshëm artistik i qytetit tonë në letërsi "Netët e Poezisë Korçare", jo vetëm që funksiononte mbi baza klienteliste dhe abuzive, por edhe ishte shndërruar në një instrument personal në duart e

Zoti Peleshi, fjalën e kam unë, apo e ke ti



nuk e dimë për ç'arsye! Kjo do të thotë të përbuzësh artistët e tjerë, bashkëqytetarët e tu.

Veprimtaritë tona pa mbështetjen e Bashkisë

Pa ndihmën morale dhe financiare të Bashkisë ne kemi zhvilluar një sërë veprimtarish artistike, falë dashamirësisë së ndonjë biznesmeni artdashës, që duhet falënderuar.

Promovimi i artit dhe kulturës nuk i shërben vetëm zbatimës së qytetarëve, por mbi të gjitha fisnikërimin shpirtëror dhe promovimit të vlerave njerëzore dhe pozitive të tyre, pasi jo çdo gjë që shkëlqen është flori.

Jemi munduar që të vlerësojmë me çmime honorifike jo bejtexhinjtë dhe grafomanët, por ata që kanë krijuar vlera të mirëfillta artistike në të gjitha fushat e krijimtarisë. I kemi nominuar çmimet, jo pa qëllim me emra personalitetesh të shquara të trevës sonë e më gjerë që kanë dhënë kontribut po për këtë trevë. Por edhe për të mbajtur pezull në kujtesën kolektive, për të nxitur dëshirën pozitive për t'u ngjarë emrave të tillë si: L.Poradeci, M.Grameno, V.Mio, S.Spasse, J.Riza, Jorgo Seferis, nobelistit që ka qenë konsull në Korçë dhe i ka kushtuar asaj vargje të bukura. Po dhe emra të tillë si A.Simoni, T.Kavalioti kanë qenë objekt i vlerësimit tonë. Para një viti në Voskopojë realizuam aktivitetin me prirje metafizike "Arti dhe Liturgjia", ku vlerësuam edhe një prej figurave të Voskopjës, shkrimtarin, studiuesin e historisë Dhori Fallon, i cili para dy muajsh u nda nga jeta dhe ish një nga të fundmit e diplomuar në Liceun Francez. Nëse ky aktivitet unik do të mbështetej, do të fitonte vlera kulturore, artistike, ekonomike dhe turistike. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit, si njerëz të penës kemi bërë takime në shkollë dhe komuna të largëta, duke gjykuar se dëshira për artin është kudo e pranishme.

vijon në faqen 5

Nga Kopi Kyçyku

Sapo ka shkrepur rrezja më e parë e diellit, që përshfaqet mes reve, si zog në fluturim. Ajri i lagur nga avullimi i ujit të liqenit të çan hundët me erën e livandos, që vjen nga fije bari të thatë, të stërkitura nga freskia e vesës. Nga larg më vijnë tinguj të zbehur thëllëzash a gargujsh. Mollët vjeshtore qeshin si fëmijë me fytyra të zbardhura nga shkumë sapuni. Ca nga ca, mugëtira mëngjezore davaritet, njerëzit dalin si nga dheu. Mbi ta derdhen rrezet diellore. Një britmë e lëshuar nga gjoks femre e dredh ajrin duke u thërrmuar në mikrojuhona në largësi. Pas kujzës së një qeni endacak, që goditet nga një gur i nisur s'dihet nga ku, bie sërish heshtja. Sikush merr udhën drejt vendit të punës.

Kjo është Vërdova e zbkuruar nga ndërtime të shumta. Ndjej kënaqësi që banorët e saj të mençur e trima tempullin e dikurshëm fetar të Shën Prokopit e kanë mbajtur po tempull, këtë herë laik, vatrë edukimi, shkollë. Përposh, sa të ze syri, shpina malesh të gjelbër e të zhveshur, herë të thikët, por më shumë të rrumbullakuar nga një dorë mjeshtrorë. Në këto vise, me të cilat jemi miqësuar pa zor gjatë kohërave, në shtëpitë e fshehura mes kodrash, a në lugje, nuk ka munguar asnjëherë bujaria për mikun e udhëtarin, streha për komitin e atdhetarin. Dhe gjithmonë, me nuhatje të hollë, jemi çapitur pas gjurmëve të „ligjit të progresit“, në Kontinentin Plak me hap dinamik prej të riu. Pas këtyre ndjesive, kam dëshirë të them dy fjalë për bashkëqytetës të mi.

Të gjithë gëzojnë të drejtën të depërtojnë në mendjen time, të konsultohen me mua në e pafshin të udhës. Ama zemra ime është paradhoma në të cilin nuk hyn dot kushdo. Aty futesh vetëm me ftesë...

Të ftuarit e mi, sot janë disa njerëz të veçantë, që i nderoj me gjithë shpirt e që nuk janë përmendur shpesh. Janë shumë, kanë mosha dhe profesione të ndryshme. Por një gjë i bashkon: dashuria e pamatë për nënën-nosit, Enkelanën. Ajo i lindi, i mëkoi me mundime, deri në vetëflim, dhe i nisi udhëve të jetës...

Fjala është për zogjtë e saj. Rreshtat që vijojnë këtë herë janë për



Zogjtë e Nositit

ata që, edhe pse - të detyruar apo me dëshirë - shtegtuan në vise e treva të ndryshme, u kthyen sërish e përfundimisht në gjirin e saj të gjerë e të ngrohtë. Thjeshtësia në punë e në jetë, qëndrimi pa të sharë ndaj njerëzve, kanë qënë e vazhdojnë të jenë bashkudhëtarë të tyre.

Me duar delikate prej violinisti a pianisti, me melankolinë e ndrojtur, i pastër deri në harrimin e vetvetes, me pamje të hijshme, zhivë në lëvizje, i zbardhur krejt pas emocioneve jo të pakta me pikënisje qysh nga fëmënia, kur mbeti jetim bashkë me të motrat e mrekullueshme. Dy sy të gjallë, depërtues e gjitha të butë, të mbushur me mirësi e shpirtgjeresi. I qeshur, me humor të shëndetshëm, i paafte për të fyer askënd, madje edhe kur ia bëjnë borxh, mosnjohës i dredhive, i smirës, i dyfytërisë, i çiltër me miqtë, i drejtë me kundërshtarët. Ky është adashi im, Kopi Nanushi, një nga inxhinierët më të zotë e më të talentuar që ka nxjerrë shkolla e lartë shqiptare e që ka ditur si rrallëkush të kuvendojë e t'i bëjë t'ia hapin zemrën e dyert e thesareve majat e maleve dhe thëllësitë e minierave. Si përfaqësues i vendit tonë jashtë shtetit, Kopi ka mbrojtur me nder, përkushtim atdhetar shembullor e kompetencë të lartë interesat e Shqipërisë, duke nxjerrë në dritë, jo vetëm vlerat e mineraleve, por edhe të shkencës

sonë. I thjeshtë si thjeshtësia, Kopi Nanushi gëzohet njëlloj si për vete me sukseset e të tjerëve dhe i ndodhet pa ngurrim pranë kujtdo që bie në fatkeqësi apo në gabime. Prania e tij në raste të tilla është vërtet vllazërore.

Gjenerali i paarritshëm, ylli polar i artillierisë shqiptare, Nazar Berberi, në momente të caktuara, ku e çuan funksionet e larta dhe detyra, hasi në kundërvënien të paarsyeshme dhe shpesh keqdashëse. Veç një gjë duhet thënë: pothuajse të gjithë që i ranë në qafë - ngaqë nuk e kuptuan, e keqkuptuan, apo u detyruan - u penduan. Dëshmitë e bashkëpunëtorëve dhe të kundërshtarëve të tij janë tejet interesante dhe vërtetojnë ndikimin e madh që Nazari ka mundur të ushtrojë në mjedisin rrethues. Mendoj se i shkon për shtat formula: "Guxim me mend në kokë" ngaqë nuk ka ndërmarrë ndonjëherë veprime të papjekura. Duke e pasur në shkallën më të epërme ndjenjën e detyrës e vetëdijën e përgjegjësisë, tek Nazari asgjë nuk i është lënë improvizimit apo rastësisë. E ka peshuar gjatë atë që do të bënte dhe, me të krijuar bindje, asgjë nuk e ka ndalur dot në udhën e nisur. Sa tërheqës e i shkueshëm me vartësit, aq edhe autoritar. Por autoritetin nuk e ka ndërtuar mbi ngjalljen e frikës e të tiranisë ndaj të tjerëve, por mbi dashurinë, besimin e

respektin e ndërsjellë. Nazar Berberi i ka fituar shpirtat, nuk i ka nënshtruar. Njerëzit i kanë shkuar Nazarit pas pangurrim, u janë bindur urdhrave të tij luftarake plot brumë, sepse në themel të të gjitha mendimeve e veprimeve ka pasur dashurinë e pamatë ndaj popullit e atdheut.

Martiri i gjallë, pjesëmarrësi aktiv në luftën për çlirim të atdheut, poeti, përkthyesi, hulumtuesi Piro Pihoni, është burri që e ka ruajtur deri në fund gjakftohtësinë e kthjellësinë shpirtërore e mendore. Ka vuajtur në heshtje dhe është zhgënjyer sa më s'ka, por nuk e la veten të mposhtet për asnjë çast nga ligësitë e fatit; vështroi dhe eci përpara; nuk harroi, por fali, nuk u ul në nivelin e në shpirtvogëlsinë e urrejtjes dhe as në shkretinë e hakmarrjes.

Përballë shpifjeve, intrigave, keqdashjes, mosmirënjohjes, vuri bëmat e mira, i bindur se këto, bashkë me të vërtetën, gjithmonë dalin fituese. Nga ky këndvështrim, mund të pohojmë se Pirua është njeri i lumtur, përdërisa në pleqëri i pa të përbushura ëndrrat fisnike të rinisë së vet: Deshi çlirimin e atdheut - u realizua; ëndërroi demokracinë - erdhi. Ky titan e ka ndërgjegjen të kulluar se i shërbeu popullit e vendit me mish e me shpirt, me dashuri e besim. Prandaj shoqëria demokratike nuk ia kurseu shpërblimin që ia pat refuzuar diktatura.

Thoma Angele, i mirënjohuri Thomaq, njeriu, të cilit natyra i ka falur dy dhunti: pikturën e kinematografinë. Të gjithë e dimë se, po t'u kushtonte të dyjave kohë të njëjtë, Thomaq do të bëhej njëlloj piktor e kineast i madh. Ky njeri është i aftë ta bëjë çdo bisedë shkëndijuese, qoftë edhe kur ka pranë figura të shquara si Lasgush Poradeci, me të cilin e lidhte një miqësi e ngushtë, miqësi talentesh të mirëfilltë, që kish në themel vlerësimin e ndërsjellë. Sytë i shkëlqejnë me një dritë të rrallë, një drithmë entuziaste ia përshkon krejt qënien sa herë flet për artet me aq dashuri e kompetencë, me aq lirizëm e lirshmëri, saqë të duket se ke përpara një apostull që predikon fenë e vet.

Thomaq të fut natyrshëm në të gjitha cepat e artit të vërtetë, në labirintin e teknikave të tij të larta, të çel horizonte të panjohura dhe të ngjit në maja me shkëlqim të papërfytyrueshëm. Tek dëgjon rriprodhimet e kujtesës së tij fantastike

Zogjtë e Nositit

për filma artistikë e dokumentarë, ndjen dhembje që ky talent i lindur, në vend ta harxhonte kohën me gojtari, duhej të ishte ulur gjatë viteve në pultin komandues të regjisorit, me kavaletin përpara.

Bektash Duka... Dy janë profesionet që kanë në dorë jetën e njeriut: mjeku dhe shoferi. Jemi dëshmitarë të sa e sa aksidenteve, që marrin jetë të pafajshme apo gjymtojnë të tjerë. Arsyeja dihet: jo rrallë patentat japin si të ishin bileta teatri apo çertifikata mirësjelljeje. Duke dhënë të holla nën dorë, apo duke shtruar dreka e darka, njerëz të papërgjegjshëm fitojnë të drejtën të ulen në timon. E, pra, mjeku dhe shoferi duhet ta marrin diplomën e patentën më me vështirësi se profesionet e tjerë. Shoferi i ardhshëm jo vetëm duhet të ketë reflekse të kushtëzuar, por nuk duhet të jetë gjaknxehtë e i padurueshëm. Edhe karakteri nuk është më pak i rëndësishëm. Servilit nuk i duhet besuar kurrsesi drejtimi i mjeteve të udhëtimit. Po qe se, bie fjala, shefi e urdhëron të shkojë me 100 kilometra në orë, kur i lejohet jo më shumë se

gjysma e kësaj shifre, në vend ta kundërshtojë, servili i përgjigjet "siurdhëron" dhe merr më qafë të gjithë udhëtarët, përfshi veten.

Bektash Duka, që u nda para kohe nga familja e nga miqtë e panumërt, ka qenë sinonimi i gjithçkaje pozitive: familjar shembullor, i ndershëm, bujar, i dashur e i afërt me të gjithë, në veçanti me të varfërit e të pambrojturit, por, mbi të gjitha, profesionist i përkryer. Ndjenja e përgjegjësisë në zbatimin e detyrës së tij delikate, shoqërohej me thellimin e parreshtur në të fshehtat e zanatit. Modestia e shtynte të dëgjonte mendimet e të tjerëve dhe sidomos t'u jepte pa kursim të rinjve, por edhe të moshuarve, këshilla të vlefshme. Nuk ishin të rralla rastet kur, në gjendjen e mjerueshme në të cilat gjendej shumica dërrmuese e rrugëve, shumë mjete të mbeteshin "në tako". Dhe Bektashi, pavarësisht se mund ta kishte mbyllur detyrën e ditës, u bëhej krah kolegëve, në shi e në diell, ditën apo natën. Për këto arsye ishte i shumëkërkuar nga të

gjithë.

Istref Haxhillari, pedagogu i talentuar, "i martuar" me shkencat e sakta, por "i dashuruar" marrëzisht me letërsinë. Tek lexon prozat e tij të shkurtra apo të gjata, krijon bindjen se trualli lasgushian e kutelian ka mbetur gjitha qjellor. Nderimi e krenaria për bëmat trimërore e mençurore, dashuria e pakufishme për këto treva, në kurmin e të cilave nuk mbin dot troska e shkurre të tjera të këqia e ku fushat e faqemalet dynden nga lulet erëmira, i japin verbit të Haxhillarit një fuqi mahnitëse tek depërton në të fshehtat e shpirtit të thellë të enkleasve.

Gjithmonë kam ndjerë gëzim për arritjet e të rinjve, por kjo ndjenjë u bëka e pakufishme kur është fjala për fëmijët e shokëve apo të miqve. Çaste vërtet të papërsëritshme provova kur u ndodha, si i ftuar nga zoti Arnold Geiger, në një sesion shkencor të Fondacionit Nehemia, që ai drejton me kompetencë, në të mirë të marrëdhënive tradicionale dhe të

frytshme shqiptaro-gjermane. Atje njoha një femër plot gjallëri, shtatvogël (edhe floriri i vogël është, por vlerën e ka të madhe), "dora e djathtë" e presidentit të fondacionit të mësipërm. Quhet Herolinda Shkullaku dhe është e bija e të ndjerit Naum Gegpriftit, pedagogut të dalluar të anglishtes, shokut tim të fëminisë e të rinisë. Të gjithë "e mbanin në gojë" (natyrisht për të mirë) Herolindën, që shquhet për aftësi të rralla si poliglote, si organizatore dhe si drejtuese e talentuar. Llazi Tona, i urtë, i matur, oreçast në gjurmët e thesareve të Mokrës kreshnike; Mihallaq Zikua, pedagog i shquar i fizikës, i mençur e gojëmjaltë si veç ai, me logjikë të fortë e shpirt të madh; Thoma Kolonja, teknik i mirënjohur që, për aftësitë e thella, i është besuar zbatimi i një numri të madh projektesh ndërtimi anembanë vendit; Ilia Llakmani, financier dhe ekonomist i përmasave evropiane, studiues i përkushtuar i historisë së vendlindjes e i traditave stërgjyshore të kësaj treve...

Po ndalem këtu për ta lënë pikëpjekjen me të tjerë në një të ardhme sa më të afërt.

Zoti Peleshi, fjalën e kam unë, apo e ke ti

vijon nga faqja 3

Propozime Bashkisë

Bashkisë së Korçës i kemi bërë propozim para një viti për mundësinë e bërjes së një shtatoreje ose busti për patriotin dhe filantropin e madh korçar Thoma Turtullin, që i ka dhuruar qytetit të Korçës bibliotekën e parë, godinën e Liceut dhe spitalin. Në propozimin tonë theksohej që në një pllakatë në bazamentin e kësaj veprë të vendosej edhe një pllakë përkujtimore, për të gjithë ata që kanë kryer vepra të tilla, apo që do të kryejnë në të ardhmen.

Pogradeci ka Lasgushin e vet dhe qytetet e tjera kanë personalitete të shquara, me karakteristika të veçanta. Për një njeri me përmasa të tilla fisnike dhe humane, si Thoma Turtulli, i cili mbetet një pikë fundamentale, më tepër se çdo gjë tjetër për identitetin tonë qytetar dhe evropian, mendojmë se është e vonuar ngritja e një shtatoreje. Po kështu ne kemi propozuar që në rrugët që të shpien në

muzetë e qytetit, si në atë Mesjetarin dhe Arkeologjikun, të vendosen disa tabela orientuese dhe reklamuese për vizitorët e huaj që vijnë dhe i vizitojnë ato dhe i gjejnë me vështirësi.

Po kështu edhe rrugët e lagjes nr. 1 dhe 2 të ishin parë me prioritet, për arsye se ndërmjet tyre kalojnë mijëra vizitorë dhe turistë në vit që vizitojnë muzetë dhe qytetin tonë. Të jesh qytetar i një qyteti si Korça, është jo vetëm privilegj, por në radhë të parë përgjegjësi ndaj bashkëqytetarëve dhe të ardhmes, ndaj fëmijëve. Po mbushen tre vjet që Bashkia aplikon njohjen e projektbuxhetit për vitin pasardhës duke marrë dhe mbledhur mendime. Mendimet shprehen dhe mbeten po aty ku shprehen. Edhe një vit më parë ne i shprehëm po këto sugjerime. Theksojmë se nuk janë shqetësime individuale, por të një komuniteti krijuesish që e duan qytetin sa të bukur dhe të këndshëm.

Si reagoi kreu i Bashkisë

Buxheti me pjesëmarrje, ku

morën pjesë lagjet 1, 2, 3 për të dhënë sadopak kontributin edhe si qytetar edhe si krijues, mbeti në mburrjet e vetë kryetarit. Logoja që po përdoret nga Bashkia në këto takime është: "Fjalën e ke ti", pra unë, ti, ai, qytetarët të flasin e të shprehin mendime dhe të bëjnë vërejtje. Por në këto takime logoja po shndërrohet "Fjalën e kam unë", pra unë kryetari i Bashkisë.

Në përgjigjen e tij kryetari i Bashkisë Niko Peleshi, mbasi përmendi sukseset e arritura nën udhëheqjen e tij nën moton çfarë do të bëjmë dhe jo çfarë është lënë pa bërë, na bëri dhe klasifikimin e shkrimtarëve dhe artistëve duke na sugjeruar se cili poet është më i madhi në Shqipëri dhe jo vetëm në qytetin e Korçës. Nuk është ndonjë mëkat i madh, të çmosh mbi të tjerët ata që vjershat e tyre i shndërruan në temjanica panegjirike për diktatorin dhe që sot me të njëjtin stil u këndojnë idhujve të rinj, por të guxosh të bësh klasifikimin e artistëve, është njëllëj si të mëtos të marrësh atributet e

sekretarëve të parë të dikurshëm që dinin mirë, jo vetëm se cili ishte poeti më i madh dhe artisti më i mirë, por edhe ku kishte naftë dhe cila vepër ishte çlirimi i parë apo i dytë i Shqipërisë. Sa për prirjen "ksenomaniake", domethënë dashurinë për artistët e huaj, Niko Peleshi dhe për nënvleftësimin e atyre që e votuan dhe që ai ka marrë përsipër t'i mbështesë, nuk dua të zgjatem, se ky është problem i tij dhe yni si qytetarë dhe krijues. Po shpreh mendimet e mia edhe në emër të artistëve dhe shkrimtarëve që më kanë zgjedhur, se, përveç festave të lakrorit apo të birrës, përveç vodevileve dhe shfaqjeve vulgare, që ai i ka shumë për zemër, ka për detyrë edhe mbështetjen e artit të vërtetë, atë që jep mesazhe njerëzore dhe që ngërthen brenda vetes vlera të vërteta dhe autentike dhe jo plagjiaturat mjerane të beniaminëve të tij.

Vladimir Toroveci

Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Korçës

15-vjetori i gazetës Nositi dhe SH.B "D.I.J.A-Poradeci"

Cilësia, kërkesa numër 1



Ilir Duka

Ka kryer studimet e larta në Fakultetin Ekonomik. Ka hyrë në rrugën e biznesit në vitin 1994 me botimin e gazetës Nositi, duke e zgjeruar në vitet e mëvonshme me botime dhe shtypshkrime të ndryshme. Aktualisht është administrator i Entit Botues "D.I.J.A Poradeci".

-intervistë me z.Illir Duka administrator i Entit Botues "D.I.J.A Poradeci"

Nositi -A ka qenë i vështirë fillimi i biznesit?

Përgjigje -Asgjë në fillim nuk është e lehtë. Gjatë viteve të para të kompanisë, kam punuar ditë e natë për të ecur biznesi përpara. Sa më shumë rritej pasioni për shtyp, aq më shumë rritej edhe firma.

Edhe faktori njerëzor është vendimtar për suksesin e firmës. Punonjësit që janë përfshirë në firmë janë të mirëkualifikuar. Jam plotësisht dakort me thënien: "Cilësia është e lidhur ngushtë tek njerëzit që punojnë në firmë". Kjo është e vetmja mënyrë që firma mund të realizojë qëllimet e saj që të jetë më shumë se një shtypshkronjë e mirë, -të jetë një furnizuese e shërbimeve kreative për çdo gjë që ka lidhje me shtypin.

Pyetje -Jeni i kënaqur me investimet

që keni kryer deri tani në fushën e shtypshkrimeve?

Përgjigje -Për mua është shumë e rëndësishme t'u ofroj klientëve të mi produkte dhe zgjedhje të cilat konkurrentët nuk i kanë akoma. Kjo është arsyeja pse unë vazhdoj të investoj në teknologjinë më të re. Shumë konsumatorë që kanë ardhur që prej fillimit të firmës janë akoma klientë të rregullt edhe sot. Kjo nuk është për t'u çuditur, pasi rregulli numër 1 në kompaninë tonë është cilësia. Duke ndjekur këtë parim i kam dhënë këtë pozicion që ka sot "D.I.J.A Poradeci".

Nositi -Çfarë shërbimesh ofroni aktualisht për klientët?

Përgjigje -Nga më të ndryshmet si: revista, postera, etiketa, fletë-palosje, katalogje, kartvizita, blloqe mandatesh

me letër vetëkopjuese, afishe, libra, gazeta.etj.

Nositi -Ju ndihmon profesioni i ekonomistit për të drejtuar?

Përgjigje -Përveçse marr pjesë në ecurinë e çdo pune në shtypshkronjë, unë jam përqëndruar gjithashtu edhe në zhvillimin e ndërmarrjes, në kujdesin e klientëve, në marketingun e firmës etj.

Suksesi im është i bazuar kryesisht në fleksibilitetin, në një çmim konkurrues dhe gjithashtu në kualitetin e besueshëm të produkteve tona.

Nositi -Si ndihesh në këtë treg, në këtë konkurrencë?

Përgjigje -Në Shqipëri vetëm pak firma kanë arritur të jenë të suksesshme në tregun e shtypshkrimeve. Në sajë të njohurive teknologjike të fituara nga eksperiencia disa vjeçare në tregun e shtypshkrimeve kemi arritur një pozicion të kënaqshëm në treg.

Nositi -Çfarë synime keni për të ardhmen?

Përgjigje -Qëllimi jonë për të ardhmen është: "Të jemi gjithmonë të gatshëm për t'iu përgjigjur kërkesës së tregut."

Intervistoi: Anjeza Begolli

Të botosh një gazetë apo "hapësira lirie në letër"!



Afroviti Gusho

Ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Natyrore, dega Matematikë. Botuese dhe kryeredaktore e gazetës Nositi që prej vitit 1994. Ka botuar dy vëllime me poezi. Ndërsa në librin e saj "Hapësira lirie në letër", përmbledh artikuj dhe editorialë të botuar në gazetën Nositi në periudhën 1994-2005.

Të botosh një gazetë: ky ishte një trill i juaji, një ëndërr, një dëshirë e hershme apo një biznes i mbështetur në arsyetimin e ftohtë?

Përgjigje -Ka qenë një dëshira ime për të shkruar dhe botuar. Krijimet

-intervistë me kryeredaktoren e gazetës "Nositi", zonjën Afroviti Gusho

e para në poezi e prozë (kryesisht hartime), i përkasin kohës së gjimnazit. Me pas në vitet e universitetit tentova të botoj në gazetën Studenti dhe në shtypin e kohës. Ishin vitet para '90 -ës. Fryma e çensurës ndjehej kudo. Në vitin 1989 diktatura filloi të shpërbëhej, ndryshimet në vendet e Evropës Juglindore po i afroreshin dalëngadalë Shqipërisë. Po lindte një shpresë për liri. Lëvizja studentore na gjeti banorë të Qytetit Studenti. Na përfshiu. Ishim idealistë. Dhe besoj kemi ngelur të tillë. Të pandreqshëm. Katër vite më vonë në qytetin tonë të vogël krijuam "Nositin", unë, Iliri dhe shumë nga miqtë tanë, krijuam hapësirë për mendimin e lirë. "Hapësirë lirie në letër" e kam quajtur unë "Nositin" dhe kështu kam titulluar librin e botuar para dy vitesh me editorialet e shkruara nga unë.

-Ç'kujtoni nga edicioni i parë i "Nositit" në qershor 1994?

Përgjigje -Ka qenë edicion me 4 faqe, sponsori i parë kanë qenë Miço e Lorenc Ndini, që sapo kishin hapur Bar Restorant Boranën. Në faqen e parë shkruhej: Nositi fton të gjithë intelektualët të shprehin mendimin e

tyre të lirë në faqet e kësaj gazete.

-Ku keni hasur më tepër vështirësi në këta 15 vjet të botimit të gazetës: në anën financiare, mirëkuptimin me lexuesit, në marrëdhëniet me shtetin?

Përgjigje -Pak nga të gjitha! Por është një eksperiencë e çmuar.

-Në këto 15 vjet ç'kujtoni si periudhën më të bukur dhe më të begatë për gazetarinë?

Përgjigje -Atë kur pas daljes së edicionit të radhës s'pushojnë telefonatat e ankesave në redaksi, kritikata, hatërmbetjet. Kjo do të thotë që e kanë lexuar "Nositin". Periudha më e begatë për Nositin është tani. Interneti e ka bërë botën e vogël dhe Nositin e lexojnë pogradecarët e dashamirës të tjerë në çdo vend të botës. Dhe na shkruajnë. Dhe komunikimi me ta është një kënaqësi e veçantë.

-Ç'i keni dhënë gazetës në 15 vjet dhe ç'ju ka dhënë ajo?

Përgjigje -Nuk kam bërë ndonjë bilanc. As analizë kosto-përfitime. Kjo për faktin se kur ka nisur botimi i Nositit, media nuk konceptohej si biznes. Ishte

diçka midis pasionit, idealizmit, dëshirës për lirinë e fjalës, sfidë për të pamundurën. Ndërsa Nositi na ka dhënë një emër të dytë. Ka plot njerëz që na identifikojnë me emrin e Nositit, mua, Ilirin dhe krejt biznesin. Është e zakonshme në Pogradec të dëgjosh: Aha, (Afroviti) kjo është e Nositit, do shkoj tek Nositi për të marrë disa shtypshkrime, jeni të Nositit? Ej, Nositi, si kaloni?







-Është e vështirë për një femër të jetë gazetarë? Po drejtuese gazete?

Përgjigje -Është diçka e tejkualuar sot. Media ka qenë dhe mbetet domen i mbizotëruar nga burrat. 15 vjet më parë të ishe kryeredaktore e një gazete ishte një habi. Sot ke gazetare të suksesshme kudo, në median vizive dhe të shkruar. Ndoshta nuk janë ku do ta meritonin në drejtim dhe ky është një diskutim i gjatë.

Sot, të drejtosh një gazetë, duhet të përballësh me tregun mediatik, me konkurrencën, me zhvillimin e teknologjisë, me sfida financiare. Nuk mjafton vetëm të ëndërrosh e të kesh pasion.


Intervistoi: Ilir Buzali

Botime në vite të Sh.B. "D.I.J.A - Poradeci"



*I dashur autor!
Të duhet shumë mund e sakrifica,
net pa gjumë për të përfunduar
librin tënd në prozë apo poezi. Ti
mezi pret ta marrësh në duar
librin tënd të ëndërruar. Por nuk
të duhet vetëm një shtypshkronjë;
ti ke nevojë edhe për një redaktor
dhe një korrektor letrar, që libri
yt të reflektojë kulturë. Atëherë ti
mund të trokasësh tek Enti
Botues "D.I.J.A. Poradeci", ku
do të gjesh të vetmen shtëpi
botuese në Qarkun e Korçës, me
një eksperiencë 15-vjeçare. Së
bashku me të, edhe një
shtypshkronjë cilësore. Ti mund
të dorëzosh këtu vëllimin tënd në
dorëshkrim dhe ëndrra jote bëhet
realitet. Brenda një kohe të
shkurtër do të kesh në duar
librin tënd, të redaktuar e të
shumëfishuar.*

"Otreshi" nga Hajder Lilo



Me një strukturë disi të çuditshme, por tepër domethënëse kjo novelë e Hajder Lilos, të jep përshtypjen e një filmi dokumentar ku kamera, tepër kapriçioze, kalon nga një pamje në tjetrën duke ndjekur personazhin kryesor dhe mikrobotën rrethoqark. Pjesa e parë dhe më e gjatë e librit titullohet "E përditshme", rreth 100 faqe, që pasohet nga një pjesë e dytë e titulluar

"Endërr" me rreth 20 faqe dhe përfundon me "Mbyllje" që përbëhet vetëm nga një rresht: "Epoka e banalizimit global mbërriti. Urime!" Në këto përmasa të zhdrejta endet Presori, intelektuali provincial i lodhur nga jeta.

E gjithë historia e këtij personazhi fillon dhe mbaron brenda një dite. Mjafton kaq për ta njohur, sepse e nesërmja është po ajo, po ai zgjim, po ata tipa që has në rrugë, po ajo ditë pune në shkollën e fshatit, që mbyllet në mënyrën më të zakonshme e më klasike për një intelektual province, në pijetore e së fundi në makthin e ëndrrave të çmendura që e bashkojnë me Ajnshtajnin, Darwinin, Galileun e të tjerë.

Nga një lexim i vëmendshëm vihet re se autori ka një bagazh të gjerë jetësor, të cilin ka ditur ta vërë në efikasitet të plotë. Veçanërisht për t'u theksuar është këndvështrimi ironik i botës dhe i ngjarjeve. Në lojën e prezantimit të tipave e personazheve përdoret një skemë e thjeshtë: një ngjarje, në shumicën e rasteve komike, e pastaj një përfundim ose përgjithësim filozofik për jetën. Novela nuk ka intrigë apo ndonjë subjekt që të të tërheqë me kurthet e njohura të befasive. Ajo ka një shtrirje lineare, me copëza ngjarjesh si një mozaik, që janë të gjitha në funksion të motivit bazë: kronika nga jeta e përditshme në provincë. Elementët e një humori të hollë e të zgjuar e bëjnë librin të këndshëm dhe tërheqës.



"Ringjallet Rilindja e Lasgushit":

Petro Prifti i rikthehet edhe një herë Lasgushit me këndvështrimin e tij origjinal, si studiues dhe si polemist.

Vlerësime dhe rivlerësime, fakte të reja, të pathëna më parë; Lasgushi, ashtu siç e ka njohur Petro Prifti.

**Botimi më i ri i shtëpisë botuese
"D.I.J.A Poradeci",
çmimi 1000 lekë**

**Për banorët e Pogradecit ka
30 %
zbritje**



Shtëpia Botuese

Në fondin e Shtëpisë Botuese tashmë ka një numër të konsiderueshëm librash në poezi dhe prozë, të autorëve nga Pogradeci, Korça, Devolli e Kolonja, Tirana, Përmeti,

Kosova, Maqedonia, madje edhe nga autorë shqiptarë të diasporës në Europë, SHBA e Kanada. Këtu autorët gjejnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me stafin botues. Botimet tona,

sipas vlerësimit të vetë autorëve, çmohen për punën e kujdesshme në redaktim dhe korrektim, duke respektuar njëkohësisht edhe kërkesat dhe individualitetin e shkrimtarëve apo poetëve.


Një tufëzë me poezi



Studiuesi i letërsisë Muharrem Xhaxho prezantohet këtë herë si poet. Ka një arsye të fortë dhe një ngacmim të brendshëm për këtë, të qenit gjysh. Kjo të kujton edhe Hygoin e madh, i cili mes motiveve të tij tragjike të romaneve tronditës, ka shkëlqyer me librin për të vegjël "Arti i të qenit babagjysh".

Poezitë e Xhaxhos për të vegjël përmbledhen në një vëllim të titulluar "Zogu i stinës" dhe autori i merr motivet nga natyra, nga fshati, nga jeta e përditshme. Jo më kot Muharremi gjatë procesit të botimit të librit, këmbënguli që në faqen e parë të shkruhej "Biblioteka e fëmijëve". Është një bibliotekë që aktualisht ka nevojë për autorë vendas e jo vetëm për përkthime.

"Gënjeshtër puthja me ty"



Mësuesja e re e letërsisë Ernesta Spaho hedh hapat e parë në profesion e njëkohësisht edhe në poezi. Libri i parë i saj "Gënjeshtër puthja me ty" përshkohet nga një lirizëm i këndshëm rinor e fluid, ku janë të pranishme pranë e pranë dashuria, malli, puthjet, premtimet, zhgënjimet... "Në zemrën time mbete/ Thjesht, një imazh gri,/ Një buzëqeshje dimërore,/ Një lot i ngrirë, i heshtur..." Kështu shprehet autorja në një prej poezive të saj, duke eksperimentuar me metaforën.

Hapi i saj i parë në poezi premtion për të ardhmen. Libri i saj "Gënjeshtër puthjet e tua" është një kartvizitë e poetes së re, me pretendime për libra të tjerë.

**Zgjedhja e sigurtë
kërkon një bankë të sigurtë.**

Depozita
me interes fiks
deri në*

9% Lekë
6,25% Euro

*Norma e interesit është në varësi të afatit dhe shumës.



www.bpopullore.com

**BANKA
POPULLORE**
SOCIETE GENERALE GROUP

Së bashku për të ardhmen

Jeta në skenë

Shoqata "Nëna, Fëmijët, e Ardhmja" Korçë

GRATE në ROLET e BURRAVE | BURRAT në ROLET e GRAVE

'00 - '08 ALBUM

CREATIVE CITY

Creative City

2004-2007 katalog

LLAQI ZOTO

dhe dielli LIND...

Poezi & Dramaturgji

Enver Hasa

Gjurmë poezi

EJALA magjike

Tregime dhe përralla për fëmijë

Bujar Braho

tufëza esesh

Brenda qenies së Adoleshencës

Klito Fundo

Kujtimet e Korçës Ringjall

ALTON BEJKO

poezi

Shqipen po e hanë...

Poëzi

TE KONKURSIT NOSITI

Anna Kove

Pa ringjallje

Robinjë e çliruar, paqja sot
si stuhi më kaloi mbi gjoks
shkuli pemët që mbolla
në tokën e premtuar të gëzimit,
krojet e puthjes
u shterën nga mall' i zharitur
u vranë sythet e porsabuisur
të mollëve pamëkat
jargavanët u shkërmoqën
në shtratin e zbrazur të ëndrrës
peshqit magjikë ngrinë
në liqenin e dëshirave
mbetur paplotësuar
dhe bluja e tij dha shpirt
në jeshilen e pashpresë...
Kryqëzuar mbeti ndjenja
atje, në dëborën e ngjyrosur
nga gjaku i trëndafilin të egër,
për të vdekur si ti, Imzot
tradhtuar nga dashuria.
Pa ringjallje!

Maj

Në maj bulërojnë me dhimbjen e lindjes
gonxhet e lulelandros
dhe shpirt jep zëmekur kjo ndjenjë
ndjekur nga klithmat e grizhlës.
rreth meje këndojnë ngjyrat si zogjtë
dikush ngjyen penelin në shtatë ylberet
e zemrës dhe më fton të jetoj me lulet
ditën e Shëngjergjit...
Pse s' di t' i gëzohem ndryshimit?
E përzhitur nga dielli yt
më duhet të rilind mbi lëkurën time
që ende përcëllon
më duhet forcë... sa të shoh rrotull.
S' është pak!

As në ëndërr

Një bisk i tharë jam
pa pranverën e gjelbër të syrit tënd
shkërmoqem
nga vështrimet e stinëve pajetë.
Gjethe e zverdhur është trupi,
vjeshtë
pa prekjen e përndezur
të mendimit tënd
që ende rrugëton
nëpër dimër.
I mpiksur gjaku
në kapilarë zhgënjimi
mavi kullon
mbi jargavanë
purpur' i trishtimit
për një fjalë
që kurrë s' m' u tha
as në ëndërr...

Mos ik!

Kur je larg
Ma le trishtimin e syve në terr
Kur je afër
ti vjen nga drita
Dhe sytë e mi hënën ngjyrosin.
Mos ik!
Sa ta rrëzojmë këtë diell
Mbi trupat tanë
Me ylbere enigmash mbështjellë.

Dritan Kiqi

Lindja e perëndisë sime

Zemër, sytë të qeshin kur më sheh
Po ta them shqip atë që zemra do
Me qepalla shpirtin lart ma ngre
Fryma jote dimrin tim e ngroh

Kur të shqiptoj ca fjalë dashurie
E ti më prek me gishtat e përplotur
Ndjej dhimbjen të më ndjekë pas si hije
Veten shoh të vogël, të paplotur.

Një puthje më mjafton nga ato buzë
Shqiptuar veç me heshtje e pa fjalë
Nga shpirti im një lule do këpus
Do të ta fal, ta bësh ti vajz' a djalë.

Nga barku yt do lindë si perëndia
E ti, nënë e shenjtë do i rrih pranë
Në luftë do kalojnë ditët e mia
Që të pushtoj për ju, botën mbanë.

Dhe në s' e bëfsha dot atë që duhet
Do të shqiptoj në lutje veç ca fjalë
Në thënça kot një fjalë që s' thuhet
Nëna e perëndisë do të më falë!

Zemër, sytë të qeshin kur më sheh
Po ta them shqip atë që xhani do
Veç një fjalë shpirtin lart ma ngre
Fryma jote dimrin tim e ngroh.

Rilindje

Lëngo në shtrat, o shpresë që shuhesh
Rënko në heshtje e prit të vdesësh
Nuk ka rëndësi që botës t' ia thuash
Me dhimbjen tënde bën mirë të qeshësh.

Dorën mbi gjoks vendos e prit
Të fundmin trok të zemrës së thyer
Qirinjtë e ndezur ngri dorën e fik
Se drita e tyre është pis, e përlyer.

Mos prit me ankth që larg të shuhesh
Por lutju zotit të të falë mençurinë
Të pranosh atë që ndoshta s' thuhet
Në fund të flesh bashkë me përjetësinë.

Se kur ty gjumi të të ketë zënë
Do zgjohem unë atëherë, i ri
Me gaz do pres që hëna e ngrënë
Të ikë e një shpresë e re të gdhijë.

Tiranë, 14 dhjetor 2008

Do ngrihem natën të të zgjoj

Do ngrihem natën të të zgjoj, moj mike
Trëndafilin që mban fshehur të ta prek
Lëndinën do të ta ndaj shtigje-shtigje
Deri sa ta gjej të errët shteg.

Në burim, kur ëndrrat të të shpien
Do më gjesh, tek po lag buzën e tharë
Kodrat, atje lart do ndjesh tek ngrihen
Nektari mbi çarçaf rrugën do marrë.

Me mendje do më pyesësh: Ku po shkon?
Por goja s' do ta thotë të shkretën fjalë
Diku, jashtë, larg, një buçe që rënkon
Do të të bëjë të ndihesh e përdalë.

Ky mendim i mendjes pa mendime
Do të ta lodhë shpirtin pa mbarim
Këmbët do shtrëngosh rreth qafës sime
Si për të thënë ik-hajde o tundim.

Rënkimi do të t' sjellë fjalët që s' thuhet
Do t' i them unë, ato që ti s' i thua
Do duash shumë, do bësh ato që duhen
E unë do bëj ç' ka s' duhet, se unë dua.

Në fund fare shpirti do të t' qeshë
Do ndjehesh mirë, e bukur, si lavire
Fryma jote do më pëshpëritë në vesh
"U kënaqe zemër? Tani, natën e mirë!"

Tiranë, 22 tetor 2006

Ëndërrën ma theve

Kur bota ka rënë e gjumi e ka zënë
Një zëth pëshpërin me frikë
Në natën me hënë, me hënë e ngrënë
Më thotë: Afromu një çikë!

Më afër se ç' jam, të shkoj më nuk kam
Moj mike me sy të pruarur
Afruar tamam, kaluar siç jam
Të kënaq ky shtrat, pa t' munduar!

Me turpin që ke e fjalët që the
Mendova se keq ti u ndjeve
Por jorganin përdhe, ngrihesh e ngre
E pashpirt! Ëndërrën ma theve!

Pranverë 2007



Poëzi

TE KONKURSIT NOSITI

Elona Zhana

Bruksel

**WHAT A WONDERFULL
WORLD!**

Mjafton një fjalë

Për të bërë botën.

...Një veprim sado banal

Për të krijuar një koncept.

Mjafton një shikim

Për të ndjerë

...Dy përshpëritje të liga

Për t'u urryer.

Mjafton një rrugë

Për të ndjellë shpresën

...Një shpresë e thyer

Për të mbjellë zhgënjimin

Mjafton një burrë

Për të vuajtur

...Një tjetër dhe pak kohë

Për të qeshur sërish

S'duhet më, veçse një e qeshur

Për të kapur qiellin e shtatë

...Një qiell gri

Të të hapë varrin.

Duhet ca të qajtura

Për t'u «burrëruar»

...Burrërimi

Për të vlarë spontanitetin

Duhet një e qeshur

Për një të prekur

Dhe një e prekur për t'u afruar

Ose për t'u ndarë

Duhet ndarjet

Për të tjera zbulime

...Zbulimet për të ndjellë ëndjen

Dhe ëndja të mashtrijë logjikën

Duhet logjikë, mes të tjerash, për të bërë
para

Mjafton paraja për të vlarë.

Duhet vrasje që të flitet për paqe

E paqja për të ushqyer ëndërra

Mundet, një ëndërr të nxisë manitë

Duhet manitë par lavditë e të zgjuarve.

Duhet të vdekur për arkivole

Dhe të sëmure për tu paguar mjekët.

Duhet një pulë të bëjë një vezë

E pa, duhet një vezë, po do ketë një pulë

Kur t'i kem ardhur unë rrotull kësaj çështje

Do jetë djegur supa ime në tenxhere

Dhe: ose më duhet t'ja rifilloj

Ose të shqepem së kënduari (ndërsa mbaj
zorrët me dorë)

What a wonderful world!

Kur më zë malli për të

(Poradecit)

Moj lesheverdhë, moj bjondinë

ku më je pash Perëndinë?

Në gjumë ëndërr; zgjuar vegim

Eja moj, mos rri kujtim.

Moj lesheverdhë, engjëll-djallëzuar,

n'atë mot kur je larguar,

zembrën time ndjenjë-veshur,

flakë e ndeze, borë e ftohe

shkëmb më shkëmb ç'e rrokullise,

njëmijë copash moj ç'e grise

shigjetvreri në mes ja dhe...

As mbi dhë as nën dhë!

Prapë se prapë s'u ngope moj,

më tërbave, më mahnite,

me hire e me sehire

ngrite kurthe e fshehe shtigje...

Një herë, më ftoje pranë,

Fill më pas bëje hatanë.

Moj lesheverdhë, Zot në ke

leri nazet e më eja,

në mos ardhsh, do bëj qametin

flakën do t'i vë qytetit

faji t'i mbetet Poradecit!

Kostaq Duka

Çikago

Dëshirë

(*fjalë të pathëna kurrë gruas sime*)

S'ka rëndësi kohëzgjatja e jetës,

Pas 50 viteve grija shtëllungohet, paprerë,
pafund....

Mirë është udhëtimin e nisur dekada më
parë një gushti të nxehtë

Ta përfundojmë së bashku, qoftë dimër a
pranverë.

Se e di po të ik unë papritur

Mungesa ime çdo ditë do i nderë mantel të
zi dhimbjes,

Sikurse mos qënia jote, ecjen drejt vdekjes
do ma bëjë ferr.....

Të jesh më këmbë

Një dorë unë

Një dorë infermierja.

Dhe masën mishtake, të nderë si një

mbetje llave mbi dysHEME

E ngritëm më këmbë....

Mbështetur mbi krahët e hekurt të

karrocës si mbi shpatulla mali,

Masa mishtake, mori trajta njerëzore;

Sa mirë kur je ngritur- tha

Botën e zotëron, e ke poshtë të gjithë...

Prill 2009

Tingujt

Një kërcitje dritareje,

Një gërvishtje dere,

Një e klithur fëmije,

Zhurma rutinore, jete...

Të njëjta

Në çdo pikë të globit të tokës....

Dhe ndodh

Ndodh sa shpesh!

Tek dëgjoj britma fëmijësh në lodrim

*Kur vetë përpëlitem nën kthetra gjumi të
pagjumë*

Fëmininë ritakoj

Tek kacavirrej

*Mbi muret e shtëpisë në ndërtim, të
fqinjtit....*

Dhe ndodh

Një gërvishtje dere

Profilin e nënës të më sjellë pranë

Me merakun, a ke fjetur bir?!...

Zhurmat

Pastaj përzejehen, andej, këtej....

Zhurmat minore, delikate bashkohen

Me rrapëllimat e autostradës së makinave,

Me jehonën gjëmimtare të avionëve,

*Të ngritjes e rrëzimit vrastar të ujit të
shatërvanit,*

Të së qeshurës të të rinjve nga pishina....

Dhe....

Papritur konturet shpërbëhen

Herë zjarrmohen

Herë zbardhen.

Unë

Pikë e nderë pezull pa drejtpeshim.

Zgjothem

E kuptoj se kam fjetur...

Dhe se është çasti i një dite të re për punë.

Jugor

Shtëpia ime

Shikonte nga Jugu

*Ndaj me diellin luaja si me shokun më të
mirë...*

Poezi

TE KONKURSIT NOSITI

Trupin
E laja
Pranë postafit herë me kova
Herë me zorrën plastike të ujitjes së luleve.
Lakuriqësinë e nderja
Mbi rrezen e nxehtë.

Edhe pse në stomak
Kisha dy patate e dy cironka
Endërroja plazhe oqeanesh me peshkaqenë
Dhe vajza drithëruese si era.....

Shtëpia ime shikonte nga jugu
*Në Shoqatën e Jugorëve të Botës kishte
hyrë përjetësisht.*

Si shtëpi bamirëse
Në sofatet e gurtë
Për një dorë diell priste e përcillte
Fqinjët e hijeve.

Gjuha e dashurisë
Mjafton gishti yt
Derën të prekë
Ajo ka për t'u hapur vetë...
Një grimë buzëqeshjeje të nderë buza jote
Tek unë shpërthen - pranverë...
Pak rastësisht gjoksit t'i japësh zbulesë,
Në tërë linjat e trupit tënd shpërnda hem i
panginjur, i sertë.

Chicago, maj 2009

Kozeta Zavalani
Përtej Oqeanit

Me erën e shkalluar,
shëtis nëpër natë.
Mbi dallgët e oqeanit
yje të dashuruar;
ndjehem e lumturuar.
Shikimet shkëmbejmë me dallget
që lodrojnë mbi valë.
Era, si gjysmëbota midis gjethesh
me palmat e jetës,
luan.
Me zemrën e dallgëve,
rënkton e shkallon,
duke kërkuar këngët e zogjve,
në pikëzat e ujit
ëmbël cicëron.
Këtu, buzë oqeanit
ishujt e virgjër
të shpirtit
i kthen në lot të trëndafiltë....

*** Në Sant Croix**

E pashë kaq pranë diellin
të lindë në agim,
tek puthte Ishujt e Virgjër,

krejt të virgjër,
që Kristofor Kolombi i pagëzoi
me emër të brishtë.
Me ledhatimin e rrezeve të tij,
hapa sytë
dhe përpiva gjithë mrekullitë...
Në ballkonin tim një tavolinë
me lule
pret të vijnë miqtë.
Ata janë larg,

shumë larg
e dot s'mund të vijnë...
Prej andej sjellin puhizën e agimit.
E vetme në ballkon përsias
Vetëm me erën mikeshë
që më ledhaton gjithandej
e diç më pëshpërit në vesh.
Dy dashnorë nëpër dallgë më shohin me
zili.

Më ftoj në pranë tyre të ri;
oqeani e dielli...
** Vendi kur për herë të parë shkeli
K.Kolombi më 1493, kur zbuloi Amerikën*

Bisedë me diellin

-Mos m'u largo- më foli,
se unë të ndjek ngado.
Sharmin tënd e shijoj vetëm unë
Nuk bëhem xheloz
dallgët e oqeanit kur përqafton.
Unë do të ledhatoj përsëri,
E përsëri do të dal
veç për ty
se e di:
Dashnor besnik më ke
përjetë.

mërzitesh kur s'më sheh ndonjë ditë
kur retë plot zili më dalin në pritë...
Eja më shtrëngo
Nuk iki pa të puthur dhe një çikë
Mos u turpëro
Tek ty, janë në gjumë të gjithë...

Lori

Poezi

Dhe një ditë ti s'më the
dhe një ditë ti s'më pe
një ditë ti më the s'je
atë ditë ti më le.

Unë këtu, ti atje,
ti je sot, unë jam dje
të mendoj dhe nuk fle
të kërkuj ku nuk je.

Pastaj malli më ze
kujtoj kohën që s'qe
kur të humba ish dje

sot jam unë, s'jemi ne.

Ti ke frikë se s'më njeh
unë kam frikë, nuk di pse
në një cep me harë
s'ka pak gas dhe për ne?!

Kur të shoh, dielli nxeh
tani është nat' me re
velat janë grisur dhe
s'po fryn era këte'

Bukuroshja që s'fle
o... e zeza e ve
prë'sja e veshur si pre
ti je një dhe je tre

Më je hý, më je fe
je e zbritur mbi dhë
në s'beson, të bëj bë
dorën dhe në zjarr ve

Un' nuk dua të t'le
mendoj ty gjithnjë se...
nuk po di as përse...
ti më le... ti s'më njeh...

Mariklena Niço

Grua

Humnerë,
unë ty të avitem përherë
sepse je një grua, si unë.

Kur të mbështetet qielli në bark,
yjet të mbushin cit me parandjenja.

Tek të shoh aq të qetë,
të përhershme,
s'më duhet të mbështetem tek ti,
as t'i anko hem gjithësisë
për gratë që sillen si humnera.

Trupi i një gruaje
është plot luspa e gjemba
kur ajo nuk do.

Shpirt' i një gruaje
ngjan me brumë lotësh e gjaku,
humbisni tekta futni duart për t'i dhënë
formë.

Ajo, në bark përziën ujë dhe rrufe,
në buzë ka ëndrra, në qumësht zemrën
kurse me duar i jep formë gjithçkaje.

Ora e këngës së natës

Oshëtijnë,

Poëzi

TE KONKURSIT NOSITI

kremtojnë e gremisen.
Janë thirrje të largëta.
Është ora e këngës së natës.
Me zërin e saj,
ajo thith gjakun tim,
por ka tingullin
më të ëmbël
nga të gjithë zërat.

Përsëri duke ujitur terr.
Mes bregut të fjetur të saj,
yjet rrinë pezull
si të mbyturit e vetëm.
Hijet mbrehin kuajt e mungesës,
pluhuri i nisjes ngrihet në re.

Figurë e një dite

Helm
Prej
Ditës
Sime
Rrjedh
Helm

Kërkohet nga unë ta pij
Me dashuri e përlulje

Dritë
Rrjedh
Prej
Helmit
Tim
Dritë.

Në kujtesën time prej shpirti

Trishtëhem
sepse mëngjeset më nuk ndodhin
sepse ditët nuk ndryshojnë nga një ditë
e hedhur kot në të shkuarën
Ndryshohem në maskën time të blerë
në tregun e të vërtetave të lira.
Mpakem
në kujtesën time prej trupi,
në humbjen që krenaria e sëmurë
e quan të hirshme.
Aty nga natyra e epërme
nuk ka asgjë;
vetëm ngërdheshje.

Mpakem në derdhjen time prej trupi
Ngrohem, në kujtesën time prej shpirti.

Do më flakin, do më shpërndajnë në botë.

Lavjerrësi me dhëmbë të bardhë.
qeshet në terr.
Kafshomë,
tek vdes si njeri, nën rroba,
jam krejt tjetër gjë.

Dua të zbulohem,
ta thyej trupin,
të përplasem fort,
të shpërndahem.
Dielli le të bjerë mbi mua të shndërruar,
mbi ish këmbët e mia të lëna në qoshe,
mbi qafën time në shtrat, mbi gjoks,
mbi dhëmbët e kuq të verës
që përhapin aromë.
Do të hapin nesër dhomën,
do më kujtojnë të larguar,
pastaj do të venë ca rregull në shtrat.
Do më mbledhin në fletë librash
Do më flakin
Do më shpërndajnë nëpër botë.

Edmond Shallvari

Greqi

Botën zhvesha...

Botën zhvesha lakuriq
Si dashnor i shkrehur
Për çudi e virgjër ish
Lule e paçelur.

Unë e dija të përdalë
Rrugësh prostitut'
Nëpër gjithësi vërdallë
Shitur nder e trup.

Aah, moj botë lakuriqe
Ç'po më le hutuar
Ti e veshur kurvë ishe
Zhveshur-virgjëruar!

Dhe pa to...

Të pranoj pak Helenë
Dhe pak Penelopë
Sigurisht pak Zhulietë
Dhe pak Desdemonë.

Këto i them më shumë për botën
Se unë s'ndjej mungesë
Dhe pa to të kam të plotë
Skllave-Mbretëreshë.

Zhënjimi

Ooh, sa ka kjo jet' zhënjime
Që shkrijn' gurin, jo më burrin
Më çorbosin në mendime
Dhe nuk di ku e kam uni-n!

Si ciklon më flakin tutje
As andej dhe as këtej
S'ka mëshirë, falje, lutje
S'di ç' mendoj e s'di ç'të them!

Pak t'i huaj mençurisë

Drejt çmendisë rrugën marr
Ky zhgënjim qenka i pistë
Dhe pa luajtur, më ze mat!

Ne rrojmë dhe pa to...

Trokas murin ndarës, trak-trak!
Ai rënkon nga kocka e dorës
Goja lëviz e hapet pa fjal'
Niset drejt teje, mesazhi i kohës.

Përgjigjen o mik, ma kthen me trak-trak!
Muri lëshon rënkimin sërish
Nga kockat tona bëhet me gjak
Të dyve na bashkon, ky mur me shpirt.

Pa gdhirë të pagdhirët na marrin
Burgu gjëmon nga muri me shpirt
Skeletet tona në litar i varin
Ne rrojmë dhe pa to, o mik!

Mërmëris...

Më mirë kështu dua...
Mërmëris...
Veshët e botës shurdhuar
T'i bezdis!
As më parë s'më dëgjuat...
Në klithmë!!!
Zërin humnerash dëbuar
Më vdiqtë!

Unë megjithatë vazhdoj...
Mërmëris...
I gjallë, i vdekur, njëlloj
T'ju bezdis!

Mendimet e "lira"

Dhe të dua s'i mbledh dot
Mendimet e dala
Diku të përçara
Masakruar e lënë pa zot!

Pranë ju afrohem si fajtor
Oh sa më dhembin!
Po pse më trembin?
Janë timet e jo timet, ato!

Nga mendimet e mia prangosur
Lirinë ju dhashë
Të lira s'i pashë
Kësaj bote-qeli, burgosur!

Ngujim

Hapësirë e ngujuar kullës së shpirtit
Shpirt i ngujuar kullës së jetës
Jetë e ngujuar kullës së mitit
Mit i ngujuar kullës së gënjeshtres.

Unë i ngujuar kullës së uni-t
Tjetri i ngujuar kullës së tjetrit
Ne të ngujuar kullës së fundit
Fund' i ngujuar kullës së universit.

Horoskopi javor i "Nositit"



Dashi (21.3-20.4)

Në punë do të realizoni një projekt që do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes financiare.



Demi (21.4-20.5)

Në takimet tuaja të kësaj jave do të merrni guxim për t'i thënë gjërat hapur. Surpriza për ju.



Binjakët (21.5-21.6)

Do të përpiqeni të bëheni të guximshëm dhe do t'u falni besim e siguri njerëzve tuaj të familjes.



Gaforrja (22.6-22.7)

Mos e ekzagjeroni prepotencën tuaj sepse askush nuk ju duron. Duhet të sqaroheni me kolegët tuaj.




Luani (23.7-23.8)

Do të kaloni një situatë të sikletshme. Duhet të jepni dhe të merrni mirëkuptim dhe solidaritet.



Virgjëresha (24.8-23.9)

Një keqkuptim me një mikun tuaj, do të sqarohet shpejt. Një person që ju ka braktisur mund të rikthehet.



Peshorja (24.9-22.10)

Ka mundësi të gjeni mes të njohurve tuaj të rinj një atmosferë të gëzueshme dhe çlodhëse.



Akrepi (23.10-22.11)

Duhet të keni shumë kujdes nga fjalët që ju thonë, sepse jo gjithçka që shkëlqen është ar.



Shigjetari (23.11-22.12)

Do të përballeni me një situatë jo të këndshme, por që do të menaxhohet drejt nga ana juaj.



Bricjapi (23.12-20.1)

Do të keni shumë kontakte kryesisht me kolegët, por edhe me persona që do të njihni rishitas.



Ujori (21.1-19.2)

Dëshira që keni për të përmbysur gjithçka do të jetë zgjidhja më e mirë. Mos eksperimentoni.



Peshqit (20.2-20.03)

Duhet të merrni vendime të rëndësishme e përfundimtare në punën tuaj, duke kontrolluar çdo detaj.



Një natë njeri del nga një lokal i pirë tapë! Merr rrugën për në shtëpi dhe në një kthesë përplasat me një murgeshë; e merr murgeshën, i fut një grusht dhe e plas në tokë, sa pa u ngritur mirë ajo ky i fut dhe nja ca shqelma të tjera në bark dhe në fytyrë sa ajo s'po lëvizte më nga vendi... dhe i thotë:

-O BATMAN, po të dija më të fortë more!

2 policë pasi kishin sekuestruar një arkë me bomba, po e çonin në komisariat. I thotë njëri tjetrit.

-Shefo, po sikur të na plasim këto bombat?

-Hë, mor burrë, mos e çaj kokën se vejmë vetëm 2 në procesverbal.

Qëlloi njëherë Hitleri në kinema. Në mes të filmit teshtit dikush. Hitleri ngrihet në këmbë dhe pyet se kush ishte. Asnjëri nuk kthen përgjigje.

Atëhere ai thërret Hansin (gorillën e tij). Hansi merr shenjë dhe i frikëson të gjithë ata në rreshtin e parë. Filmi vazhdon më tej. Dëgjohet prapë në sallë një teshtimë.

-Kush ishte? -pyet përsëri Hitleri.

Ngrihet njëri nga spektatorët me lot në sy dhe duke u dridhur nga frika. Hitler i qetë i thotë:-

-Po SHENDET, o burri i dheut.



Vipat Top Sekret

Polanski kërkon të mos ekstradohet në SHBA

Gjykata, një nga instancat më të larta gjyqësore të Konfederatës, konfirmoi se kishte marrë një ankesë nga Roman Polanski kundër mandat arrestit të lëshuar nga Zyra Federale e Ministrisë së Drejtësisë.



- Gjykata zvicerane njoftoi sot se kishte marrë një ankesë nga kineasti franko-polak, Roman Polanski kundër ekstradimit të mundshëm në SHBA, theksoi Gjykata Federale Penale në Bellinzona përmes një komunikate.

"Gjykata, një nga instancat më të larta gjyqësore të Konfederatës, konfirmoi se kishte marrë një ankesë nga Roman Polanski kundër mandat arrestit të lëshuar nga Zyra Federale e Ministrisë së Drejtësisë", theksoi ai. "Javët e ardhshme do të merret një vendim", nënvizoi gjykata.

Schwarzenegger, Polanski si të tjerët

Schwarzenegger ka autoritetin, si guvernator i Kalifornisë, që t'i japë faljen Polanskit, nëse kërkohet, pas ekstradimit të regjisorit të filmit të famshëm 'Chinatown'.

- Guvernatori i Kalifornisë, Arnold Schwarzenegger tha se regjisorin e famshëm hollivudian Roman Polanski duhet të trajtohet njëjllë si gjithë njerëzit e tjerë, nëse vjen në SHBA të për t'u përballur me dënimin për



marrëdhënie seksuale me një vajzë 13-vjeçare në vitin 1977. I pyetur nëse do të shqyrtohet falja e Polanskit, aktori aktualisht guvernator deklaroi për CNN-in se 'do të përballej me këtë situatë në të njëjtën mënyrë si me këdo tjetër'.

Schwarzenegger ka autoritetin, si guvernator i Kalifornisë, që t'i japë faljen Polanskit, nëse kërkohet, pas ekstradimit të regjisorit të filmit të famshëm 'Chinatown', i cili u arrestua në Zvicër pas një urdhërarrestit amerikan. Polanski, i cili ka kombësi polake dhe franceze, u largua nga SHBA-ja në vitin 1978 pasi u vetëdeklarua fajtor në një gjykatë të Kalifornisë, për marrëdhënie seksuale me një të mitur.

SHPALLJE KONKURSI

Konkursi i përvitshëm poetik mbarëshqiptar online “Nositi” 2010



-Materialet për konkursin fillojnë të dorëzohen në janar deri në fund të gushtit 2010.
 -krijimet do të dërgohen online në adresën e “Nositit” **redaksianositi@yahoo.com**
 -çdo autor mund të marrë pjesë me 1-3 poezi në shqip
 -mund të marrin pjesë të gjithë shqipfolësit pa përjashtim, nga çdo vend (shqiptarët dhe të huajt shqipfolës)
 -poezitë pjesëmarrëse do të jenë të publikuara dhe të verifikueshme nga çdo përdorues i internetit
 -poezitë do të publikohen nga gazeta “Nositi” në internet, **www. poradeci.com**

Shtatori do të jetë muaji i votimit për autorët më të mirë
 -të gjithë pjesëmarrësit kanë të drejtën e votës. Secili ka në dispozicion 6 vota, nga të cilat 3 vota duhet t’i japë autorit më të mirë, 2 vota vendit të dytë dhe 1 votë vendit të tretë. Votimi do të jetë transparent dhe do të bëhet publik online. Fituesit do të përcaktohen vetëm nga votat e autorëve pjesëmarrës.

Tetori do të jetë muaji i shpalljes së fituesve

REDAKSIA E GAZETËS “NOSIT”

Horizontalisht: 1.Ka kryeqytet Adisabeba 6.Qytet me kala në vendin tonë 10.Notë muzikore 11.Qeliza seksuale femërore 13.Gjysmë sasi 14.Inicialet e aktores Ljarja 15.Poemë e Homerit 17.Qytet lagunor 18.Gjysmë tapë 19.Korça në targa 20.Opera e Moxartit 25.Pjalm ose... 26.Nënprodukt i qumështit 27.Inicialet e piktorit Kodra 29.Indiumi në tabelë 30.Eshtë dru pyjor 32.Mamur pa zë 33.Tish..., kompozitor 34.Këngëtarja Qazimi 35.Romani “...e Forsajtve” e Xh.Gollsuorth 36.Notë muzikore 37.Eshtë një njeri i dhunshëm 38.Një model sferë 39.Lena pa notën muzikore 40.Ajo me tre harqe e Kadaresë 42.Eshtë shtet arab 45.Një... pagan 46.Dramë e Çehovit 48.Lidh dy brigje 49.Inicialet e ish peshëngritësit Kondo 50.Emri i ish kryeministrit Çarçani 51.Vendi i nisjes 53.Këngëtarja Bektashi 54.Loni..., shkrimtar 55.Targa e një qyteti në Shqipërinë e Mesme

Vertikalisht: 1.Aktorja Luarasi 2.Qytet spanjoll 3.Ngjitet në... ai që fiton 4.Këngëtarja italiane Spanja 5.Ari në tabelë 6.Vihet në zgjedhë 7.Armë mesjetare 8.Shënohet i pari 9.Aktori Paçino 12.Flet ose... 14.Autori rus i romanit “Nëna” 16.Elementi kimik me simbol As 21.Ramiz..., ish president 22.Simboli kimik i manganit 23.Qarkullonte në Evropë para euros 24.Lumë në vendin tonë 25.Lumë në Itali 28.Lloj peshku 30.Kryeqyteti i Senegalit 31.Qytet indian 32.Emri i ish spiunes së famshme Hari 33.Gruaja e Skënderbeut 36.Më afër... se qilari 41.Veli..., humorist 43.Tokë që mbillet 44.Igli..., futbollist 47.Instituti i Lartë Pedagogjik 50.Inicialet e Moisiut 51.Aktori Prosi, inicialet 52.Inicialet e shkrimtarit Laço

1	2			3	4	5		6		7	8			9
10				11				12			13			14
15			16					17						
										18			19	
	20	21		22		23		24						
25						26							27	28
		29			30				31			32		
	33						34				35			
36					37								38	
39			40	41					42	43	44			
45				46		47			48					
49			50					51					52	
	53					54						55		

Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 466)

Horizontalisht: 1.Bekenbauer 8.MG 11.As 12.Llakaj 13.Kurt 14.Shi 16.Lima 18.Portokalli 21.AK 22.AN 23.SR 24.Oto 25.Ti 26.Naim 28.SR 30.Iv 31.Ea 32.IT 33.Elba 34.HK 37.Han 38.AD 40.Tarzani 43.Nudo 45.IRA 46.Han 47.Amazona 50.MMI 52.Ag 54.Olim 55.Reis 57.Roma 56.FK 60.Ansambli 61.Ata 62.AI

Vertikalisht: 1.Bukureshti 2.Karpate 3.Estonia 4.Bostoni 5.Uliksi 6.EL 7.Raul 8.Mali 9.Gji 10.Gjakova 15.HO 17.Mati 19.Armenia 20.Lisbona 27.Athina 29.Ra 35.Karmen 36.Bah 38.Adolf 39.Donika 41.Ramis 42.Na 44.Uzo 48.Mima 49.AM 51.Isa 53.Gri 55.Ra 56.SB 58.AT

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Në kompjuter: Edlir PODA
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
redaksianositi@yahoo.com